



„Pasha fikun

dhe ullirin“, fillon sureja „Tin“ e Kur'anit Fisnik, ku All-llahu i Lartësuar betohet në këto të mira dhe begati që ia dhuroi njerëzimit. All-llahu xh.sh. i përmend dhe betohet në to në Kur'anin Fisnik dhe dihet se Ai i Lartësuari betohet vetëm në diçka të rëndësishme. Njëherë, Ebu Derdaja ia kishte ofruar të Dërguarit të All-llahut s.a.v.s. një pjatë me fiq të freskët, kurse Ai s.a.v.s. ishte kthyer kah të tjerët duke i ftuar që të hanë së bashku me të. Me këtë rast u kishte thënë: “Sikur të përmendja ndonjë pemë që bie nga Xhenneti, do të thosha se është kjo pemë, sepse pemët e Xhennetit nuk kanë berthamë“. Dhe kishte shtuar edhe këtë „Hani nga kjo pemë se kjo i pengon hemorroidet, shëron njerëzit leshtor dhe ndihmon në rastet me artrit (lat. Arthrolithiasis)“.

Ka disa lloje të fiqve, kurse lloji më i mirë është fiku i bardhë, i cili duhet të piqet dhe të qërohet para se të hahet. Fiku (arab. Tin; lat. Ficus carica) është një frutë e këndshme, e cila në vete përmban ngrohtësi dhe është shumë ushqyes. Pema e fikut është nga familja e trumzës. Gadishulli Arabik, veçanërisht pjesa jugore e tij, është i pasur me fiq, për shkak të tokës pjellore. Përdoret i freskët, i tharë dhe i përpunuar në produkte të ndryshme. Përmban shumë karbohidrate, mbi 73%, albumina 2% dhe 3,1% yndyra. Fiqtë e njomë kanë mjaft vitaminë C, provitaminë A, vitaminë B1, hekur, kalcium, fosfor, klor, magnezium dhe bakër. Në 100 gr. fiq gjenden 270 kalori.

Ngrënia e fiqve shëron zërin e ngjizur, u bën mirë mushkërive dhe fytit, ripërtërin mëlçinë dhe shpretkën, pastron këlbazën si sekrecion të trupit në lukth. Fiqtë janë të mirë për nerva, e hapin traktin tretës dhe më së miri është kur hahen me arra dhe bajame. Lehtë kalon nëpër zorrë, prandaj përdoret si laksativ, diuretik, hap bllokimet dhe shuan etjen që shkaktohet nga mukusi (jarga) i njelmët. Gjithashtu shëron problemet me kollë kronike. Ngrënia e fiqve të freskët e pengon zhvillimin e urinës toksine, ndihmon në nxjerrjen jashtë të shtresimeve (sedimenteve) të

urinës dhe zbërthen sedimentet me rërë që mund të bëhen gur të veshkave. Megjithatë, ngrënia e tepërt e fiqve nxit krijimin e morrave. Nga ana tjetër është i pasur me sheqerna, që prodhojnë energji të madhe në trup. Për atë shkak këshillohet të mos përdoret prej atyre që vuajnë nga sëmundja e sheqerit. Rekomandohet të përdoret nga personat e dobësuar, anemikët dhe nga ata që ndiejnë shumë ftohtë ngase i jep organizmit forcë dhe nxehtësi. Fiku parandalon rënien e flokëve, mënjanon erën e rëndë të gojës. Qumështi i fikut ka gjetur përdorime praktike për heqjen e kallove. Gjethet e njoma të fikut kanë veti terapeutike shumë të mira kundër sëmundjes së astmës. Merren 1-2 gjethe të freskëta dhe zihen në 200 ml. ujë, gjersa të mbetet gjysma e sasisë së ujit. Lëngu i fituar pihet në mbrëmje para gjumit ose në mëngjes në lukth të zbrazët.

Lus Allahun e Lartësuar ta pranojë këtë vepër që është thjesht vetëm për hir të Tij dhe për asgjë tjetër. Falënderimi i takon Allahut, Zotit të të gjitha botëve, kurse bekimet dhe përshëndetjet tona qofshin mbi zotërinë e të gjithë të dërguarve, Muhammedin s.a.v.s. mbi të gjithë të dërguarit dhe mbi të gjithë besimtarët.

(Insha-Allah vazhdon me përshkrimin e ullirit)

Përgatiti: Suzana Hasani

Literatura e përdorur:

1. „Thesare në Kur'an” – Saimir Bulku, Orjeta Deda (Bulku)
2. „Mjekësia e të Dërguarit Muhammed s.a.v.s.” - Ibn-Kajjim el- Xhevzi (Dr. sci. Ali F. Iljazi)
3. „Mjekësia profetike” – Imam Xhelaluddin es – Sujuti (Dr. sci. Ali F. Iljazi)
4. „ Mjekësia e Muhammedit s.a.v.s.”- Imam Xhelaluddin es – Sujuti (Muhammed Bajrami)